



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7, paragrafi 1.31 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më 24 dhjetor 2020 miraton:

RREGULLORE NR. 07/2020
PËR
ANGAZHIMIN DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR KOMPENSIMIN E
PËRKTHYESVE DHE INTERPRETËVE QË ANGAZHohen NË SISTEMIN
PROKURORIAL

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja ka për qëllim angazhimin dhe përcaktimin e tarifave për kompensimin e përkthyesve dhe interpretëve për angazhimin e tyre në procedurën penale në sistemin prokurorial, duke iu referuar certifikimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore do të zbatohet brenda sistemit prokurorial, me rastin e angazhimit të interpretëve ose përkthyesve në procedurë penale.

Neni 3
Përkufizimet

Në këtë rregullore, shprehjet e mëposhtme kanë këtë kuptim, si:

SKPK – Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Çift i gjuhëve - nënkupton dy gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës, ose një gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës dhe një gjuhë të huaj, nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën dhe anasjelltas.

Interpret - është çdo individ i certifikuar, i cili përmes interpretimit në gjuhët e caktuara mundëson komunikimin më të lehtë në një procedurë penale.

Përkthyes - është çdo individ i certifikuar që kryen rolin e lehtësuesit të komunikimit me anë të përkthimit të dokumenteve të shkruara.

Përvojë e punës - në kuptim të kësaj rregulloreje është përvoja në përkthim, përfshirë sektorin privat, publik dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 4

Kriteret për angazhimin e interpretëve ose përkthyesve

1. Personi që do të angazhohet si interpret ose përkthyes në sistemin prokurorial duhet të plotësojë kriteret si në vijim:
 - 1.1 Të jetë i certifikuar nga KGJK-ja për një çift gjuhësh;
 - 1.2 Të ketë kartelë të vulosur nga KGJK-ja dhe vulë me përmbajtje të çiftit të gjuhëve, për të cilin është certifikuar, si dhe
 - 1.3 Të jetë i regjistruar në regjistrin e interpretëve dhe përkthyesve të certifikuar nga KGJK-ja.
2. Prokurorët dhe njësitë e tjera brenda sistemit prokurorial mund të angazhojnë interpretë ose përkthyes të jashtëm nëse interpretët ose përkthyesit e regjistruar në regjistrin e KGJK-së nuk e mbulojnë një çift gjuhësh që është kërkuar.
3. Interpretët dhe përkthyesit e jashtëm duhet të plotësojnë kriteret në vijim:
 - 3.1. Interpreti apo përkthyesi i jashtëm duhet të ketë diplomë universitare.
 - 3.2. Të ketë së paku dy vjet përvojë pune si interpret apo përkthyes.
4. Nëse interpreti ose përkthyesi nga paragrafi 3 i këtij neni nuk është në dispozicion, interpreti ose përkthyesi duhet të ketë së paku katër (4) vjet përvojë si interpret ose përkthyes në gjuhën përkatëse.
5. Nëse interpreti ose përkthyesi nga paragrafi 4 i këtij neni nuk është në dispozicion, interpreti ose përkthyesi duhet të tregojë aftësi të mjaftueshme për të interpretuar ose përkthyer saktë dhe pa anim në gjuhën përkatëse.

Neni 5

Procedura për angazhimin e interpretëve ose përkthyesve

1. Angazhimi i interpretit ose përkthyesit në procedurë penale do të bëhet me vendim nga prokurori i rastit në bashkëpunim me Zyrën për Përkthim dhe Lektorim në SKPK.
2. Zyra për Përkthim dhe Lektorim do të sigurojë në vazhdimësi regjistrin me të dhënat e interpretëve dhe përkthyesve gjyqësorë, të certifikuar nga KGJK-ja, i cili do t'u dorëzohet administratorëve të prokurorive.
3. Prokurori i rastit do të kërkojë nga administratori sigurimin e interpretit ose përkthyesit nga regjistri i të dhënave për interpret ose përkthyes.
4. Në rast se përkthyesi ose interpreti nuk i përgjigjet ftesës, Administratori i Prokurorisë përkatëse njofton KGJK-në nëpërmjet Zyrës për Përkthim dhe Lektorim.

Neni 6

Skema e kompensimit

1. Përkthyesit, respektivisht, interpretët, do të kompensohen për shërbimet e dhëna sipas skemës së përcaktuar në këtë nen:
 - 1.1. Për përkthimin e dokumenteve nga një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës në një gjuhë të huaj dhe anasjelltas do të llogaritet çmimi prej 0.03 € për çdo fjalë të përkthyer.
 - 1.2. Për verifikim të përkthimit, që ka bërë një person tjetër, përkthyesit gjyqësor i takon gjysma e kompensimit nga paragrafi 1.1 i këtij neni.
2. Për interpretimin nga një gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës në një gjuhë të huaj dhe anasjelltas, si dhe për interpretim nga një gjuhë e huaj në tjetrën:
 - 2.1. Për një orë intepetimi - 25.00 €.
 - 2.2. Për orën e filluar - 15.00 € (deri në 30 minuta), duke llogaritur kohën e humbur për të ardhur dhe kthyer në vendin, ku është kërkuar përkthimi.

3. Në kohën e llogaritur për interpretim, përfshihet koha e kaluar në vajtje-ardhje të interpretit. Llogaritja bëhet si në vijim:

- 3.1. Deri në 20 kilometra vajtje-ardhje, pa kompensim;
- 3.2. Prej 21- 60 kilometra vajtje-ardhje, 1 orë;
- 3.3. Prej 61 - 100 kilometra vajtje-ardhje, 2 orë dhe
- 3.4. Prej 101 - 200 kilometra vajtje-ardhje, 3 orë.

4. Për punën që përkthyesi apo interpreti, me kërkesë të palës apo në raste urgjente, kryen jashtë orarit të përcaktuar të punës apo në ditët e fundjavës dhe të festave, kompensohet në bazë të nenit 56 të Ligjit të Punës nr.03/L-212.

5. Forma e pagesës do të rregullohet me formularë.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësit e përkthyesve dhe interpretëve

1. Interpretët dhe përkthyesit kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- 1.1. Janë të obliguar që t'i përgjigjen ftesës së prokurorit apo njësive të tjera brenda sistemit prokurorial;
- 1.2. Të kryejnë interpretimin apo përkthimin në kohën e caktuar nga prokurori;
- 1.3. Të kryejnë punën në mënyrë profesionale dhe konfidenciale, si dhe
- 1.4. Obligohen që t'i përmbahen Kodit të Etikës për përkthyes dhe interpretë.

2. Në rastet kur interpretët apo përkthyesit gjyqësor, të regjistruar në regjistrin e KGJK-së, shkelin Kodin e Etikës për përkthyes dhe interpretë, menjëherë njoftohet KGJK-ja.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2021.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2020

Bahri Hyseni

Kryesues i Këshilli Prokurorial i Kosovës

